



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 5/2026

I Mbajtur në takimin e V-të të rregullt të KK-së me datën 30.04.2026, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e V-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Betimi i anëtarit të ri të zëvendësuar;
3. Miratimi i rendit të ditës;
4. Miratimi i Procesverbalit
5. Raporti financiar për periudhën Janar - Mars 2026;
6. Propozim – Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesës të ngastrës kadastrale; 81-0 Z.K. Sazli, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 753-0 Z.K. Sazli, pronë e Komunës së Ferizajt;
7. Propozim – Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 63-5, 63-6 Z.K. Gërlicë, pronë private, me qëllim të këmbimit me ngastrën kadastrale 195-0 Z.K. Varosh, pronë e Komunës së Ferizajt;
8. Propozim – Vendim për Diskutim Publik të Rregullores për taksa komunale;
9. Propozim – Vendim për Dhënie afatgjatë të ngastrave kadastrale; 1510-0, 1511-0, Z.K. Rahovicë dhe
10. Pyetje dhe Kërkesa.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi theksoi që sa i përket pjesëmarrjes nuk kam ndonjë informacion për mungesë sa i përket rendit të ditës, rreth rendit të ditës a ka dikush ndonjë çështje.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që propozoj që pika e 7-të të tërhiqet nga rendi i ditës, pasi kemi marrë edhe disa peticione të Fshatit Varosh të cilët janë kundër, po ashtu propozoj edhe një pikë të re plotësim ndryshimin e vendimit për lista të pronave për dhënie në shfrytëzim ku propozojmë të tërhiqen dhe ka të bëjë për parcelat te spitali i ri ku nuk duhet të jenë në këtë listë.

Habib Krosa pasi përshëndeti të pranishmit thekson që kjo është hera e 3-të që kjo çështje po sjellën në kuvend dhënia e parcelës 195-0 në Varosh është e pa pranueshme pasi po bëhet fjalë për një pronë e cila është në interes të banorëve të asaj ane, ne nuk mund ta zgjidhim një rast individual duke e cenuar interesin e komunitetit, dhe krijojmë precedent duke e përdorur pasurin komunale në këtë mënyrë, kërkesa ime është e kuartë që të hiqet pika e 7-të dhe të shikohet mundësia e kompensimit të një forme tjetër, ne kemi edhe ankesën apo petitionin gati për ta përcjellur edhe në MAPL, ju faleminderit.

Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit thekson që me vjen keq që kemi ardhur në këtë situatë pasi si kuvend kemi largu 2-3 herë nga kuvendi qoftë përmes ankesave qoftë përmes komenteve nga kolegu, mirëpo nga ajo që kemi parë është se ne atë pronë nuk ka as ndonjë projekt konkret, sa i përket kësaj ankese këtu ne kuvend nuk trajtojmë ankesa dhe unë jam kundër hjekjes së kësaj pike.

Habib Krosa para pak dite ka qenë edhe Drejtori Arbër dhe në rrugën “Ram Krosa” është shiku mundësia e nënkalimit dhe është vërejtur që ka një mundësi që të bëhet mbikalim fiks në atë pjesë.

Arian Imeri d.m.th. nëse e shikojmë parcelën aty vërehet që në atë pronë ska mundësi me u realizu asnjë projekt.

Kryesuesi e qet në propozim rendin e ditës si e keni marrë me material ku kaloi me 24 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi është për hjekjen e pikës së 7-të ku për tu hjekur votojnë 9 për, ta lënë në fuqi 19.

Kryesuesi e qet në votim propozimin e Brahim Osmanit për listë të pronave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë edhe për ta hjekur për këtë pikë votojnë 15 ndërsa për ta lënë votojnë 20.

Kryesuesi pyet nëse ka dikush për procesverbal dhe nuk pati vëretje dhe kaloi me 24 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e fton Heset Maliqin si anëtar të ri ta bëjë betimin si asambleist.

Kryesuesi e lexon pikën e 5-të të rendit të ditës dhe ia kalon fjalën Drejtoreshës Sebahate Ajeti Sadiku e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që sa i përket këtij raporti Janar-Mars ju konfirmoj që 601225 € kemi të hyra vetanake pasi është vonu Ligji për buxhet është vonu rrjedhimisht është shty edhe faturimi.

Presim në periudhën e ardhshme të kemi faturim më të madh, sa i përket detajeve, e keni edhe ne propozim pjesën tabelare, për shkak të përmbarimeve ministria ka krijuar një kod të veçantë ku

mbi 7 milion nga viti kaluar për shkak të përmbarimeve kanë mbetur realisht pa investime kapitale, ku deri në 12 milion euro presim këtë vit që të kemi mungese.

Kryesuesi Konstaton se këtë pikë nuk ka nevojë ta votojmë vetëm paraqitet si raport dhe nëse ka dikush pyetje për këtë raport urdhëroni.

Kryesuesi e lexon pikën e 5-të dhe ia kalon fjalën Drejtoreshës Festina Sadiku e cila pasi përshëndeti të pranishmit thekson që kjo pikë ka të bëjë me këmbimin e pronës private si në propozim.

Pasi spati të interesuar për diskutim kjo pikë kalon me 23 vota për, 1 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexon pikën e 7-të dhe ia kalon fjalën Drejtoreshës së kadastrit e cila thekson që edhe kjo pikë ka të bëjë me këmbim si e keni edhe në material, vlen të theksohet që na Drejtoria e infrastrukturës nuk ka parapara projekt në atë parcelë.

Brahim Osmani thekson; po besoj që peticioni është i kuartë edhe ata kërkojnë që të mos kaloj, cili është interesi i komunës që me nda kështu si e keni nda edhe pse vjen gjithmonë kështu pse këtë hapësirë e keni lanë këtu edhe për mi dhanë komuna ma shumë, e leni kështu edhe veç tregona cila është interesi i komunës, edhe nga informatat jo zyrtare kam dëgjuar që drejtoresha ka kërku që me pare kesh me kry punën e tokave, edhe mendoj që këtij kuvendi kuvendit që ka shkelje më së shumti ku asnjani prej tyre se keni pru me shfuqizu.

Habib Krosa pasi falënderon të gjithë thekson që po shihet kuartë që kësaj here keni vendos me kalu këtë pikë, mirëpo para se të hidhet në votim kërkoj disa skjarime nga drejtoresha, nga pamjet kadastrale shihet se ka ekzistuar mundësia brenda korridorit ekzistues, prandaj lind pyetja nëse sot kompensohet kjo pronë, a do të kompensohet edhe parcelat tjera pasi kemi disa tjera të kësaj natyre, pasi që nëse nuk trajtohen ato do të ketë selektim, vlen të theksohet që kjo pronë përpos që ekziston projekti i nënkalimit i buxhetuar po ashtu është afër varrezave, është edhe afër parkut dhe është e kuart që kjo pronë është me interes për banorët e asaj zone, ju faleminderit.

Festina Sadiku thekson që sa i përket pretendimeve dhe kërkesave të banorëve ato nuk kanë arritur në drejtorinë tonë dhe sa i përket pjesës tjetër duhet të dini që s'kemi pranuar kërkesa tjera, vetëm ky ka ba kërkesë dhe sa i përket informatës çka do që thuhet këtu është mirë mi sjellë me fakte përndryshe është spekulim.

Kryesuesi e qet në votim këtë pikë dhe kalon me 23 vota për, 9 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexon pikën e 9-të dhe thekson që tash e tutje këto diskutime publike mund të dalin në kuvend edhe pa u vendosur për t'i votuar si vendime, megjithatë masi e kemi kështu po e diskutojmë.

Shkrute Krasniqi Neziri pasi përshëndeti të pranishmit thekson që te kjo rregullore par 24 nenin 10.7(nuk dëgjohet) ndërsa mbështetja financiare nga qeveria prej 30€ nuk është e mjetueshme dhe është e pa përballueshme për familjet, prandaj propozojmë që të ulen tarifat për ato dy paragrafë, sepse po mohohet e drejta e arsimimit për prindër të pa punë.

Sebahate Ajeti thekson që pas diskutimit do të trajtohet kjo rregullore dhe ju ftoj në diskutim publik edhe juve që të jepni kontributin për t'i përmirësuar këto tarifa për qytetar.

Kryesuesi e hedh në votim dhe kalon me 40 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexon pikën e 9-të dhe kryesuesi thekson që këtu duhet të bëhet apo kur të votohet është propozim paraprak për dhënie në shfrytëzim.

Egzona Selimi pasi përshëndeti të pranishmit thekson që po flasim për pronat si në propozim ku po bëhet fjalë për një sipërfaqe mbi 2 hektar dhe duhet të kemi parasysh që s'jam kundër zhvillimit ekonomik, mirëpo qysh drejtoresha e bjen këtë propozim me strofa kështu pa asnjë plan ideorë, ku nuk përputhet me PZH edhe pse s'kemi plan e qet një pronë që është bujqësore për kësi projekti.

Xhevat Sallahu unë jam konsultuar me një ekspert që ka fermë dhe është mirë që kemi qytetar që investon 2 milion, mirëpo me dhanë një pronë për 50 vjet një personi fizik pa garancion pa kurgja, është e pa pranushme e para, kjo e dyta, kjo është për habi që prona komunale të ipet kaq afatgjatë edhe dikush që investon kaq shumë o mirë me ble pronën se s'janë pronat shtrejtë në atë anë.

Yllka Neziri Hyseni pasi përshëndeti të pranishmit thekson që ne në parim s'jemi kundër, përkundër i mbështesim, mirëpo ky propozim është shumë i pa kuart, arsyet pse jemi kundër në këtë fazë pasi ska një plan konkret dhe ka vetëm shifra në letër, s'është paraqitur studimi i fizibilitetit, apo analiza ekonomike që dëshmon që projekti është i qëndrueshëm nuk ka mekanizëm të fortë kontrolli, pasi dihet që kjo është një periudhë shumë e gjatë dhe kërkoj që ky propozim mos të miratohet në këtë fazë pa u siguruar mirë çështjet e lartëcekura, pasi përgjegjësia jonë është të marrim vendime konkrete dhe jo të shpejta në dëm të qytetarëve.

Brahim Osmani thekson; po besoj që jam i kësaj pjese dhe e njohë personin që ka apliku dhe nuk jam kundër, mirëpo po diskutoj për pjesën procedurale pasi kuvendi duhet me formu komision e cili rekomandon kujt me ja dhanë, e dyta duhet edhe komisioni i ankesave, e pastaj të bihet në kuvend.

Kryesuesi thekson që një skjarim që te formimi i komisioneve nuk vlej në si të përgjithshëm tash për çdo pronë duhet të formohet komisioni për vlerësim e ankesa, e kemi diskutu edhe në KPF që t'i formojmë edhe komisionet për këtë pikë.

Kryesuesi e hedh në votim këtë pikë dhe kalon me 21 vota për, 7 vota kundër dhe 3 vota abstenim.

Kryesuesi thekson që tash kemi në rend të ditës pikën për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim për pikën që sapo u votua dhe për anëtarë të këtij komisioni e që propozohen:

Sadat Ismajli PDK, Amir Rexhepi LVV, Festina Sadiku ekzekutiv, Balton Dërguti nga ekzekutivi dhe nga shoqëria civile Kenan Gashi dhe ky komision u formua me 26 vota për 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim.

Kryesuesi thekson që duhet të formohet komisioni i ankesave dhe në këtë komision u propozuan: Maliq Muharremi nga PDK, Arbnor Murseli LVV, Arbër Bytyqi nga ekzekutivi, Alberton Sahiti nga ekzekutivi dhe Lorik Krasiqi OJQ. Ky komision u votua me 31 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim.

Tek pyetje dhe kërkesa, pyetje parashtruan:

Brahim Osmani Për Drejtorinë e infrastrukturës pyetje:

Brahim Osmani pyet: E kam një lutje që disa herë po ta kërkoj projektin që e keni dërgu në Ministrinë e infrastrukturës, përpos takimit që keni patur ende se keni dorëzu dhe shpresoj që do ta bëni atë projekt, pasi keni thënë që disa vite e kemi gati, ministria po e kërkon këtë projekt, e ju spo e dërgoni.

Për Drejtorinë e shërbimeve publike pyetje:

Brahim Osmani pyet: Mirëmbajtja e rrugës prej Talinofcit të Muhaxherëve deri në Rahovicë po bëhen disa seanca, që jam tu e ngritur këtë çështje dhe asnjëherë spo marr përgjigje për këtë çështje.

Shkrute Krasniqi Hyseni pyet: Kam pyetje të cilën po e përcjelli nga fshatarët e Fshatit Muhovc, kur do të fillojnë punimet për rrethrotullim, pasi po paraqitet rrezik për banorët.

Shkurte Neziri Krasniqi pyet: Shtylla elektrike janë të vendosura në oborret brenda shkollave ju lus që të bëni zhvendosjen deri sa ska ardhur te më e keqja.

Xhevat Sallahu pyet: Në Fshatin Zllatar dhe Dardani po bëhet rrjeti nëntokësor energjetik, tash në realizim të rrugës Ramjan – Zllatar rruga gypat në paramasë për reshje atmosferike gjatë punimeve që po bëhen në këto rrugë duhet të rregullohen, pasi i ka edhe kërkesat e vazhdueshme që i bëjë, po s'është duke u marrur asnjë masë, dhe as rruga që u shtrua, as zhavorri, mungon mbikëqyrja komunale si po realizohet projekti apo realizohet paramasa, ashtu e kem edhe te çerdhja mungon mbikëqyrja.

Kryesuesi me këto pyetje dhe kërkesa e shpall të mbyllur këtë seancë.

Procesmbajtësi


Leutrim Mahmuti



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi